



Imagination
Ideas Inspiration
Innovation
Negotiation
Networking
Novelties
Necessities
Coordination
Concepts
Competences



Nr. 62

Viti i gjashtë i botimit

Korrik 2018

Në këtë numër do të gjeni:

- ...me këtë rast Ju kujtojmë se...
- Tryeza e 3-të GEO e Evropës Juglindore
- Studentët janë ekspertët e ardhshëm të mjedisit, por sëpari janë qytetarë
- Procedurat e VNM / VSM në një tryezë të rrumbullakët me median
- Nxitja e krijimit dhe funksionimit të forumeve lokale mjedisore
- Fuqizimi i OMSHC-ve për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri
- Nxitja e krijimit dhe funksionimit të forumeve lokale mjedisore në PK Divjakë-Karavasta
- Takim konsultues dhe ndërgjegjësues/informues në PK Qafë Shtamë / Miqësia Ulëz
- Promovohet libri "Biologjia dhe mbarështrimi i faunës së gjuetisë"
- Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në ZM në Gjirin e Vlorës / Shoqata Flag Pine
- Nxitja e krijimit dhe funksionimit të forumeve lokale mjedisore në PK Mali i Dajtit /Pседа Iliria
- Konferencë Rajonale mbi pjesëmarrjen e publikut
- Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?
- #IAmOnEnergySavingMode / Qendra EDEN
- 5 Qershori - Dita Botërore e Mjedisit
- Njoftime

**...me këtë rast Ju kujtojmë se
4 vjet më parë...**

...me VKM nr. 495, datë 22.07.2014 miratohen

disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 693, datë 10.11.2005, të Këshillit të Ministrave "Për shpalljen e kompleksit ligatinor të Butrintit Park Kombëtar", të ndryshuar.



Parku Kombëtar Butrint



Institute for Nature Conservation in Albania
Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri

...6 vjet më parë ...

...me VKM nr. 432, datë 18.07.2012 ekosistemi natyror malor i Malit të Tomorrit, me sipërfaqe 24,723.1 ha, shpallet Park Kombëtar, duke përfshirë sipërfaqen prej 4,000 ha, të miratuar me VKM nr.102, datë 15.01.1996. Për këtë Park Kombëtar ka përfunduar dhe Plani i Menaxhimit i miratuar me urdhër të ministrit të Mjedisit nr.2027, datë 31.12.2014. Aktualisht është i përzgjedhur nga Projekti Natyra 2000 ose NatyrAL.

Administrimi i Parkut Kombëtar "Mali i Tomorrit", kryhet nga AdZM Berat, strukturë e AKZM, dhe në bashkëpunim me institucionet e qeverisjes vendore...

...8 vjet më parë ...

...me VKM nr. 546, datë 07.07.2010 miratohet lista e llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

Me VKM nr. 553, date 07.07.2010 përcaktohet sezoni i gjuetisë në Republikën e Shqipërisë...

...12 vjet më parë ...

...shpallet Ligji nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për Mbrojtjen e Biodiversitetit". Ligji ka për synim:

1. Të sigurojë mbrojtjen dhe ruajtjen e diversitetit biologjik.

2. Të rregullojë përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të diversitetit biologjik, nëpërmjet integritetit të

elementeve kryesore të biodiversitetit në strategjitë, planet, programet dhe vendimmarrjet e të gjitha niveleve.

Gjithashtu, ky ligj zbatohet:

për të gjitha sipërfaqet gjeografike, tokësore, ujore dhe detare të Republikës së Shqipërisë, pronë shtetërore apo private;

b)për të gjithë përbërësit e diversitetit biologjik, që gjenden në mjediset e përmendura në shkronjën "a".

c)nga organet shtetërore, që veprojnë në kuadër të këtij ligji apo të ligjeve të tjera të kësaj

fushe, nga personat fizikë dhe juridikë, publikë e privatë, vendas dhe të huaj, veprimtaritë e të cilëve kanë ndikim në biodiversitet, si dhe nga organizatat shoqërore dhe nga publiku.

Materiali gjenetik dhe organizmat gjenetikisht të modifikuar (OMGJ-të) nuk janë objekt i këtij ligji.

Me ligjin nr.68/2014, janë bërë disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9587, datë 20.07.2006 "Për mbrojtjen e biodiversitetit", të cilat konsistojnë në:

-menaxhimin dhe mbrojtjen e tipave të habitateve natyrore, kafshëve, përfshi shpendët e egër si dhe llojet e bimëve me interes për Komunitetin Evropian;

-përcaktimin e listave të llojeve të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve, me interes për Bashkimin Evropian.

Këto lista janë miratur me VKM nr.866, datë 10.12.2014 "Për miratimin e listave të tipave të habitateve natyrore, bimëve, kafshëve dhe shpendëve, me interes për Bashkimin Evropian", sipas anekseve të mëposhtme:

a) Aneksi I: Tipat e habitateve natyrore me interes për Bashkimin Evropian, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes;

b) Aneksi II: Llojet e bimëve dhe kafshëve me interes për Bashkimin Evropian, ruajtja e të cilave kërkon përcaktimin e zonave të veçanta të ruajtjes;

c) Aneksi III: Lloje kafshësh dhe bimësh me interes për Bashkimin Evropian, në nevojë për mbrojtje strikte;

ç) Aneksi IV: Llojet e kafshëve dhe bimëve me interes për Bashkimin Evropian, kapja në gjendje të egër, shfrytëzimi i të cilave mund të jetë objekt i masave menaxhuese; d) Aneksi V: Parimet për identifikimin e llojeve të shpendëve të egër që do të jenë objekt kërkimi për mbrojtjen dhe menaxhimin e shpendëve të egër...

...15 vjet më parë ...

...miratohet **Ligji nr.9103, datë 10.07.2003 "Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare"**, të ndryshuar.

Ky ligj synon mbrojtjen mjedisore të liqeneve ndërkufitare në gjendjen e tyre natyrore, garantimin e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e jetës dhe të ekosistemeve në to, duke nxitur zhvillimin e veprimtarive të dobishme, në përpunje me kërkesat e parimit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke ndaluar veprimtaritë që i rrezikojnë.

Ky ligj zbatohet për liqenet ndërkufitare dhe pellgun e tyre ujë mbledhës si me poshtë:

- a) për pjesën shqiptare të Liqenit të Shkodrës;
- b) për pjesën shqiptare të Liqenit të Ohrit;
- c) për pjesën shqiptare të liqeneve të Prespës...

...23 vjet më parë ...

...me **VKM nr. 364, datë 10.7.1995** miratohet një ndryshim në VKM e Këshillit të Ministrave nr. 451, datë 16.07.1993 "Për administrimin e shpellave"...

...32 vjet më parë ...

...me **VKM nr.244, datë 14.7.1986 "Për një përjashtim nga VKM Nr. 96, datë 21.11.1966 "Për shpalljen e parqeve kombëtar pyjor"**, për arsye të mbi ngritjes së digës të Liqenit të Madh për marrjen e ujit për ujitjen e tokave bujqësore...

...41 vjet më parë ...

...miratohet Rregullorja e Ministrisë së Bujqësisë **nr.1, datë 27.07.1977 "Mbi Gjuetinë"** dhe njëherazi lista e Rezervateve të Gjuetisë, duke i ndarë në kategoritë "A" dhe "B".

Në kategorinë "A" u përfshinë: Kune (Lezhë), Velipojë (Shkodër), Rrushkull-Rrotull (Durrës), Maliq (Korçë), Fushë-Kuqe-Negël-Patok (Krujë), Pishë-Poro (Fier), Karaburun-Llogara (Vlorë) dhe Ksamil (Sarandë)...

Në kategorinë "B" u përfshinë: Pishë-Poro (Vlorë), Divjakë dhe Mollas (Lushnjë), Cangonji (Korçë),

Vain, Bërzane dhe Kodrat e Pylli i Kodhelit (Lezhë), Pylli i Levanit (Fier), Qafëmollë-Derje (Tiranë), Kuterman dhe Senisht-Qerret, Mirakë (Librazhd), Pylli i Griqanit, Fierza-Mengel, Mali i Vashës-Polis i Vogël dhe Qafë Bushi-Xibrakë (Elbasan), Balloll (Berat), Velidon, Therepel-Bogovë (Skrapar) dhe Pylli i Helshanit (Kukës)...

...62 vjet më parë ...

...me urdhër të ministrit të Bujqësisë **nr. 242, datë 07.07.1956** territori në Gjirin e Lalëzit, i quajtur "Rrushkull-Rrotull", me sipërfaqe 1,286 ha, shpallet "Rezervat gjuetie".

Në vitin **1957** u sollën nga Rumania rreth 500 krerë fazanë, të cilët u lëshuan për popullim në Rezervatin e Gjuetisë Rrushkull-Rrotull, një ngjarje e veçantë për popullimin e këtij rezervati me fazanë, shërbeu si model dhe u praktikua në rezervatet e tjerë të zonës bregdetare të Shqipërisë, për shtimin e fazanit në gjendje të lirë në natyrë.

Me urdhër të ministrit të Bujqësisë **nr. 404, datë 25.01.1983**, sipërfaqja e rezervatit të Rrushkull-Rrotull zvogëlohet në 700 ha, duke hequr sipërfaqen e Rrotullës.

Sipërfaqja e rezervatit është rishikuar në vitin **1995**, dhe me urdhrin e ministrit të Bujqësisë **nr.2, datë 26.12.1995**, sipërfaqja u zvogëlua me 50 ha...

...68 vjet më parë ...

...më datën **20.07.1950** u themelua "Shoqata e Gjuetarëve dhe Peshkatarëve Sportivë"...

...78 vjet më parë ...

...më **07.07.1940** u miratua Dekreti "**Mbi Gjuetinë**". Bazuar në këtë dekret, sipas dokumentave të kohës, territori Shëngjin-Tale-Vain-Bregu i Matës, me sipërfaqe rreth 25,000 ha, u shpall "Rezervat Shtetëror i Gjuetisë".

Në vitin **1960**, me urdhër të Ministrisë të Bujqësisë, zona e Kunës, me

Vijon në faqe 4

Vijon nga faqe 3 sipërfaqe 375 ha, rishpallet rezervat gjuetie. Ndërsa në vitin 1969, zona e Vainit, me sipërfaqe 1,100 ha, rishpallet rezervat gjuetie.

Tashmë këta ish rezervate, me VKM nr.432, datë 28.04.2010, janë përfshirë në Rezervën Natyrore të Menaxhuar (RNM), Kune-Vain-Tale, i cili ka një sipërfaqe të përgjithshme prej 4,393.2ha.

Administrimi i Rezervës Natyrore të Menaxhuar "Kune-Vain-Tale", kryhet nga AdZM Lezhë, strukturë e AKZM, në bashkëpunim me institucionin e Bashkisë Lezhë.

Zagoria shpallet "Park Natyror"

Ekosistemi natyror malor i zonës së Zagorisë, me një sipërfaqe prej **24,590.32ha**, sipas VKM nr.354, datë 02.05.2018, shpallet "Park Natyror", Kategoria e IV⁺, sipas ligjit "Për zonat e mbrojtura".

Në sipërfaqen e këtij parku natyror përfshihen territore urbane, troje të përziera me tokë bujqësore e pyjore, shkurre dhe sipërfaqe ujore. Aktualisht sipërfaqja e Rrjetit Kombëtar të Zonave të Mbrojtura Mjedisore (RrKZMM) arrin në rreth 507 mijë ha ose 17.6% të sipërfaqes së përgjithshme të vendit.

26 Korrik, Konventa e Kombeve të Bashkuara "Për të Luftuar Shkretëtirëzimin" UNCCD

U nënshkruar në Paris me 17 Qershor 1994, hyri në fuqi më 26 Dhjetor 1996. Shqipëria është palë prej datës **26.07.2000**, pas miratimit të ligjit nr. 8556, datë 22.12.1999 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën e Kombeve të Bashkuara "Për të luftuar shkretëtirëzimin në ato vende që kanë kaluar thatësira serioze dhe/ose shkretëtirëzim, veçanërisht në Afrikë" (Fletore Zyrtare nr. 37, faqe 1471, data e botimit 25.02.2000).

Synimi kryesor i konventës është mbrojtja e tokave nga degradimi në zonat e thata, gjysëm të thata dhe të thata në të lagëta. Detyrimi i

konventës është që të luftohet shkretëtirëzimi, nëpërmjet zbatimit të programeve të veprimit kombëtar.

Mbrojtja e mjedisit dhe përdorimi i qëndrueshem i burimeve natyrore përbën një nga prioritetet e Qeverisë shqiptare. Frenimi i degradimit të mjedisit, humbja e vlerave të mëdha natyrore, niveli i larë i ndotjes së ajrit në qendrat urbane dhe industriale, erozioni masiv i tokës, dëmtimi i pyjeve, ndotjet e ujërave tokësore dhe detare, zonat e mbrojtura, etj, përbëjnë disa nga problematikat kryesore në rrugën e zhvillimit afatgjatë të vendit.



Tryeza e 3-të GEO e Evropës Juglindore

Selanik - 04/06/2018 - Përse na duhet një udhërrëfyes në lidhje me GEO dhe Copernicuss në Evropën Juglindore? Këto çështje u trajtuan në workshopin e projektit Geo-Cradle ku mori pjesë edhe INCA si partner në këtë projekt.

Në kuadër të projektit "GEO-CRADLE" financuar nga Bashkimi Europian, në datat 4-5 Qershor 2018, u mbajt në Selanik workshopi i rradhës i projektit. Me pjesëmarrjen e mbi 100 delegatëve që përfaqësojnë kërkues, shkencëtarë, aktorë privatë dhe publikë nga i gjithë rajoni, workshop-i u ofroi një mundësi

aktorëve kyç në të gjithë zinxhirin e vlerave të Vrojtimit të Tokës për të ndarë dhe shkëmbyer njohuri mbi veprimet afatgjata që mund të ndihmojnë në maksimizimin e ndikimit të Vrojtimit

të Tokës. Mendimet dhe inputet e takimit ishin shumë të vlefshme për ekipin e projektit GEO-CRADLE dhe përpjekjet e tyre për të zhvilluar



një plan masash për zbatimin e përmirësuar GEO / GEOSS në rajon për angazhimin e aktorëve kryesorë në nivel kombëtar dhe rajonal.

Për më tepër vizitoni <http://geocradle.eu/en/>

Studentët janë ekspertët e ardhshëm të mjedisit, por sëpari janë qytetarë

Tiranë - 13/06/2018 - Për të promovuar listat e kontrollit për vlerësimin e studimeve të VNM dhe VSM ekipi i projektit CO-SEED (i përbërë nga organizatat e shoqërisë civile INCA, Milieukontakt dhe Qendra EDEN) zgjodhi studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë së Mjedisit, Universitetit Bujqësor të Tiranës, Fakulteti i Agromjedisit dhe Ekologjisë dhe të Universitetit POLIS, Fakulteti Planifikim, Mjedis dhe Menaxhim Urban, të cilët janë ekspertët e ardhshëm të mjedisit. Pjesë e kurikulës së tyre akademike janë dhe politikat mjedisore në mbështetje të zhvillimeve ekonomike të fokusuara në projekte të ndryshme urbane dhe rurale, e sidomos në vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projekteve të ndryshme arkitekturore apo zhvillimore. Ky promovim u bë në mjediset e universiteteve gjatë një periudhe një javore, ku u zhvilluan takimet

informuese me ta.

Që të zhvillosh një zonë urbane apo rurale është e domosdoshme të vlerësosh burimet natyrore që ofron mjedisi për këtë zhvillim. Njohuritë bazë të marra në auditoret e universiteteve i kanë bërë këta studentë jo vetëm të ndjeshëm ndaj fenomeneve dhe çështjeve mjedisore që shoqërojnë zhvillimin social-ekonomik, por në rradhë të parë qytetarë të ndërgjegjshëm për të kuptuar rolin e tyre në shoqëri dhe mundësinë që u jep e drejta për informin, pjesëmarrje në debate publike dhe më tej dhe në procesin e vendimmarrjes.

Ngritja e vetëdijes dhe njohurive të tyre për transparencën publike dhe pjesëmarrjen e publikut në konsultime projekteve të ndryshme duke reklamuar takimet dhe mundësitë e diskutimit ndërmjet autoriteteve publike, investitorëve dhe komunitetit, ishte tema kryesore e takimeve informuese që ekipi i

Vijon në faqe 6

Vijon nga faqe 5 projektit CO-SEED në Shqipëri ka organizuar për studentët gjatë periudhës 4 - 11 qershor 2018. Ekipi i projektit CO-SEED në Shqipëri zhvilloi këto takime për t'i bërë pjesë në procesin e informimit, diskutimit dhe vendimmarrjes së komunitetit në zhvillimin e projekteve të ndryshme që kanë ndikim në mjedis duke iu ofruar jo vetëm një bashkëbisedim për njohjen e koncepteve të VNM dhe VSM dhe proceseve të zhvillimit të tyre, por dhe mjetet me të cilat mund të konsultohet dhe vlerësojë cilësinë e studimeve të VNM apo VSM dhe të procesit të konsultimit për to.

Gjatë takimeve, studentët u informuan mbi të drejtën e pjesëmarrjes së publikut për t'u bërë pjesë aktive në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve dhe krijimin e një mediumi ku publiku mund të gjejë mënyrat e tij të informimit dhe komunikimit për t'u angazhuar gjatë proceseve të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Vlerësimit Strategjik Mjedisor. Ekipi i projektit krijoi mundësinë e informimit të pjesëmarrësve mbi çështjet se çfarë janë VNM dhe VSM, cilët janë autoritetet publike përgjegjëse për to dhe cilat janë detyrimet e kuadrit ligjor dhe institucional

për të angazhuar publikun në këto procese, si mund të përdoren mjetet e informimit për të rritur interesin e publikut për pjesëmarrje, si dhe çfarë i ofrohet publikut/komunitetit për të kuptuar se si është realizuar një studim VNM ose VSM. OSHC-të iu dhanë pjesëmarrësve shembuj nga puna e tyre gjatë zhvillimit të projektit duke ofruar

gjetjet dhe rekomandimet e tyre për mangësitë e kuadrit ligjor institucional, shmangien nga procedurat e përsëhruara në kuadrin ligjor, si dhe mënyrën jokorrekte të komunikimit të institucioneve përgjegjëse me publikun.

Të gjithë studentët pjesëmarrës shprehën interesimin për temën dhe bënë një diskutim produktiv për angazhimin e tyre në proceset e konsultimeve/dëgjësave publike për studimet e VNM apo VSM të hartuara për projekte të ndryshme zhvillimore. Ata kërkuan detaje nga procesi i informimit dhe kuadrit ligjor që i detyron/fton publikun në këtë proces dhe shprehën qëndrimin e tyre për rastet e prezantuara.

Në fund të takimeve, ekipi i projektit prezantoi manualin mbi praktikën më të mira globale për bashkëpunim të suksesshëm midis organizatave të shoqërisë civile, autoriteteve publike dhe kompanive private në vendimmarrjen për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe vlerësimet strategjike mjedisore.

Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni www.co-seed.eu



Procedurat e VNM / VSM në një tryezë të rrumbullakët me median

Trajnim dhe bashkëbisedim me mediat -
"Procedurat e VNM/VSM - analiza, rekomandimet
dhe shembujt më të mirë të zbatimit të tyre"
Tiranë, 13.06.2018 - Zhvillimi social-ekonomik i



vendit kërkon në mënyrë të vazhdueshme të zhvillosh projekte në shërbim të komunitetit, si dhe të krijosh lehtësira në marrjen e këtyre shërbimeve. Të dizenjosh një projekt është punë e arkitektëve, inxhinierëve apo projektuesve. Ta zbatosh atë kërkohet të marrësh në konsideratë ku dhe si do të përdorësh burimet për të. Por çështjet mjedisore shoqërojnë projekte të ndryshme dhe janë një nga pjesët më të rëndësishme të procesit të zbatimit të projektit. Kjo kërkon që patjetër të përdorësh burimet natyrorë në mënyrë të qëndrueshme dhe me sa më pak veprime tjetërsuese, shkatërruese apo ndotëse. Për këtë është shumë e rëndësishme që të marrësh parasysh gjatë zhvillimit të projektit të gjitha ndikimet negative të projektit mbi mjedis dhe mbi këtë evidentim të bëhet një plan i mirëdetajuar për masat zbutjes për zvogëlimin ose shmangien e ndikimit negativ në mjedis. Nga praktikat e deritanishme, projektet kohë pas kohe nuk llogarisin saktë ndikimet e tyre dhe nuk përfshijnë masat për zbutjen / shmangien e

ndikimeve të tyre. Ky proces është ballafaquar me reagimin e komunitetit për të protestuar ose kundërshtuar projektet dhe kërkesat e komunitetit për të marrë pjesë në konsultimet / diskutimet publike dhe më tej në procesin e vendimmarrjes për këto projekte.

Ngritja e vetëdijes dhe njohurive të tyre për transparencën publike dhe pjesëmarrjen e publikut në konsultimet projekteve të ndryshme dhe rolin e medias në këto aktivitete duke reklamuar takimet dhe mundësitë e diskutimit ndërmjet autoriteteve publike,

investitorëve dhe komunitetit, ishte tema kryesore e sesionit të trajnimit që ekipi i projektit CO-SEED në Shqipëri ka organizuar për dhe me përfaqësuesit e medias në mjediset e Hotel Mondial në datën 13.06.2018. Ekipi i projektit CO-SEED në Shqipëri, i përbërë nga INCA dhe dy organizatat e shoqërisë civile Milieukontakt dhe Qendra EDEN, që kanë fituar grante nga projekti CO-SEED, zhvilloi këtë trajnim për të krijuar një urë komunikimi dhe angazhuar mediat në procesin e informimit, diskutimit dhe vendimmarrjes së komunitetit në zhvillimin e projekteve të ndryshme që kanë ndikim në mjedis duke iu ofruar jo vetëm një bashkëbisedim për njohjen e koncepteve të VNM dhe VSM dhe proceseve të zhvillimit të tyre, por dhe mjetet me të cilat mund të konsultohet dhe vlerësojë colësinë e studimeve të VNM apo VSM dhe të procesit të konsultimit për to.

Trajnimi i përqendruar në rëndësinë e gazetarëve dhe medias - vizuale dhe të shkruara - në rritjen e ndërgjegjësimit të publikut për të marrë pjesë

Vijon në faqe 8

aktive në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve dhe krijimin e një mediumi ku publiku mund të gjejë mënyrat e tij të informimit dhe komunikimit për t'u angazhuar gjatë proceseve të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe vlerësimit strategjik mjedisor, krijoj mundësinë e informimit të pjesëmarrësve mbi çështjet se çfarë janë VNM dhe VSM, cilët janë autoritetet publike përgjegjëse për to dhe cilat janë detyrimet e kuadrit ligjor dhe institucional për të angazhuar publikun në këto procese, si mund të përdoren

mjetet e informimit për të rritur interesin e publikut për pjesëmarrje, si dhe çfarë i ofrohet gazetarëve për të kuptuar se si është realizuar një studim VNM ose VSM, dhe çfarë mund të relatojnë ata nëpërmjet artikujve dhe kronikave që ata përgatisin për këtë proces. OSHC-të iu dhanë pjesëmarrësve shembuj nga puna e tyre gjatë zhvillimit të projektit duke ofruar gjetjet dhe rekomandimet e tyre për mangësitë e kuadrit ligjor institucional, shmangien nga procedurat e përshkruara në kuadrin ligjor, si dhe mënyrën jokorrekte të komunikimit të institucioneve përgjegjëse me publikun.

Të gjithë gazetarët shprehën interesimin për

temën dhe bënë një diskutim produktiv për angazhimin e medias për prezantimin e çështjeve të mjedisit në edicionet e tyre, gazetatat apo



mediat sociale. Ata kërkuar detaje nga procesi i informimit dhe kuadrit ligjor që i detyron/ fton mediat në këtë proces dhe shprehën qëndrimin e tyre për rastet e prezantuara.

Në fund të trajnimit, ekipi i projektit prezantoi manualin mbi praktikën më të mira globale për bashkëpunim të suksesshëm midis organizatave të shoqërisë civile, autoriteteve publike dhe kompanive private në vendimmarrjen për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe vlerësimet strategjike mjedisore.

Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni www.co-seed.eu

Nxitja e krijimit dhe funksionimit të forumeve lokale mjedisore

PK Shebenik-Jabllanicë - 19/062018 - Në kuadër të zbatimit të projektit "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura" (Faza II), Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri, në ndjekje të forcimit të kapaciteteve të organizatave të RrMN mbi modelet e advokimit për një vendimmarrje dhe menaxhim sa më të qëndrueshëm të ZMM dhe

burimeve natyrore, organizoi bashkëbisedimin me grupet e interesit për "Nxitja e krijimit dhe të funksionimit të forumeve lokale mjedisore".

Qëllimi i takimit ishte të konsultojë dhe identifikojë, në bashkëpunim me grupet e interesit në nivel lokal, përfaqesuesit më të mirë të përfshirjes së tyre në proceset e advokimit dhe mirëmenaxhimit të parkut kombëtar, nëpërmjet përfaqësimit të aktorëve kryesor *Vijon në faqe 9*

Vijon nga faqe 8 lokal në një strukturë të përbashkët - Forumi Lokal, pranë strukturave vendore përgjegjëse në Parkun Kombëtar "Shebenik-Jabllanicë".

INCA do të propozojë modelin e strukturës dhe mënyrën e funksionimit të këtij forumi, së bashku me organizatat partnere të OJF-ve lokale, stafin e Bashkisë dhe Administratën e Parkut Kombëtar. Gjithashtu, INCA do të synojë informimin dhe ndërgjegjësimin e anëtarëve të forumit mbi problematikat e vrejtura (gjatë fazës së I-rë të projektit) dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre, bazuar në legjislacionin e fuqi.

Ky aktivitet u realizua në kuadër të Programit SENIOR-II, i zbatuar nga REC-Albania, me financim nga Qeveria Suedeze (Embassy of Sweden in Tirana).



Fuqizimi i OMSHC-ve për të promovuar mbrojtjen e natyrës në shqipëri

PK Shebenik-Jabllanicë - Kune-Vain - Porto Palermo - PK Divjakë-Karavasta - Qershor 2017 - Në kuadër të projektit "Fuqizimi i Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile për të promovuar mbrojtjen e natyrës në Shqipëri", nën mbështetjen e programit IPA të BE, "Shoqëria Civile dhe Media 2016-2017, Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri - INCA, ka nisur turin e takimeve dhe prezantimeve me përfaqësues lokalë dhe të shoqërisë civile pranë PK Shebenik-Jabllanicë, Rezervatit Natyror të Kune-Vain, zonës së Porto Palermos dhe PK Divjakë-Karavasta. Qëllimi i takimeve është identifikimi dhe njohja me komunitetin dhe shoqërinë civile në këtë zonë si dhe diskutimi mbi rolin aktiv advokues të grupimeve të Organizatave Mjedisore të Shoqërisë Civile (OMSHC) në

zbatueshmërinë e legjislacionit, në luftën kundër korrupsionit dhe



minimizimin e ndikimeve negative në menaxhimin e burimeve natyrore

dhe zonave të mbrojtura.



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

Përbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e zbatuesit të projektit dhe nuk reflekton pikpamjet e Bashkimit Evropian

Nxitja e krijimit dhe funksionimit të forumeve lokale mjedisore në PK Divjakë-Karavasta

PJESËMARRJA E KOMUNITETIT DHE OMSHC -ve PËR MIRËQEVERISJEN E QËNDRUESHME TË ZONAVE TË MBROJTURA MJEDISORE DHE TË BURIMEVE NATYRORE

Më 27 Qershor 2018, në mjedisiet e Qendrës së Vizitorëve të Parkut Kombëtar "Divjakë-Karavasta" (një

ndër Qendrat e Vizitorëve më të reja të krijuar në ZMM të Shqipërisë), në kuadër të zbatimit të projektit "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të

burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura" (Faza II), Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri dhe Qendra Rajonale e Mjedisit-Shqipëri (REC), në ndjekje të forcimit të kapaciteteve të organizatave të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës (RrMN) mbi modelet e advokimit për një vendimmarrje dhe menaxhim sa më të qëndrueshëm të ZMM dhe burimeve natyrore, organizuan bashkëbisedimin me grupet e interesit për "Nxitja e krijimit dhe të funksionimit të forumeve lokale mjedisore".

Ky aktivitet realizohet në kuadër të Programit SENIOR-II, i zbatuar nga REC-Shqipëri, me financim nga Qeveria Suedeze (Embassy of Sweden in Tirana).

Në takim u theksua se është i pari organizim i tillë në këtë QV të sapo krijuar, ku një nga

drejtimet e funksionit dhe të qëllimeve për të cilat është ngritur, të shërbej për të tilla takime, seminare, edukim e



ndërgjegjësim, për promovim dhe sjelljen e praktikave më të mira për mirëqeverisjen biodiversitetit dhe të përdorimit të barazpeshuar të burimeve dhe peizazhit natyror të ZMM, pa cënuar ekzistencën e tyre.

Funksionimi i kësaj QV, por edhe të të tjerave të krijuara tashmë, do të lidhet edhe me aktivitetin e planifikuar në fazën e dytë të projektit për "Krijimin e modeleve të reja për zhvillimin e aktiviteteve me bazë natyrën, në bashkëpunim me administratat e ZMM, nëpërmjet *Vijon në faqe 11*



Vijon nga faqe 10 vitalizimit të Qendrës së Vizitorëve në PK", që do të zbatohet nga INCA dhe organizatat e RrMN.

Në takim morrën pjesë përfaqësues të Ambasadës së Suedisë, në Tiranë; Drejtori dhe stafi i REC-Shqipëri; drejtuesit dhe stafi i organizatave të RMN; përfaqësues të OJF-ve lokale partner të organizatave të RrMN dhe të forumeve të ngritura prej tyre; përfaqësues të AdRZM-ve, të qarqeve Fier, Kukës, Shkodër, Elbasan, Gjirokastër, Korçë; të komunitetit të grave, të medias, nga biznesi i zonës etj.

Qëllimi i takimit ishte të konsultojë dhe identifikojë, në bashkëpunim me grupet e interes në nivel lokal, përfaqësimin më të mirë të përfshirjes së tyre në proceset e advokimit dhe mire menaxhimit të parkut kombëtar, nëpërmjet përfaqësimit të aktorëve kryesor local në një strukturë të përbashkët - **ForumLokal**, pranë strukturave vendore përgjegjëse në Zonat e Mbrojtura Mjedisore.

INCA, gjithashtu, propozoi modelin e strukturës dhe mënyrën e funksionimit të forumit local mjedisor, i cili u diskutua së bashku me organizatat partnere të OJF-ve lokale, stafin e Bashkisë dhe Administratën e ZMM. Gjithashtu, INCA informoi, në kuadër të ndërgjegjësimit të anëtarëve të forumit, mbi problematikat e vërteta (gjatë fazes së I^{re} të projektit) dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre, bazuar në legjislativacionin e fuqi.

Në këtë takim u kërkua për të diskutuar dhe

refkletuar edhe ndaj problemeve që na shqetësojnë si RrMN, për funksionimin dhe ristrukturimin e mëtejshëm që duhet të bëjmë për t'iu përgjigjur më mirë situatave dhe duke kërkuar të realizojmë standartet për një përsqasje evropiane të shoqërisë civile shqiptare. Falë bashkëpunimit me REC dhe mbështetjes së Ambasadës Suedeze, që nga krijimi i tij me programin SENiOR-A (2013) e deri më sot, RrMN e ka përmirësuar performancën e vet, është konsoliduar dhe mbetet pjesëmarrës për të adresuar në mënyrë profesionale në politikat lokale dhe qendrore, promovimin dhe adresimin e një menaxhimi të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore, kryesisht në ZMM.

Gjatë zbatimit të Programit SENiOR-II, është kërkuar dhe realizuar që të kemi një përfaqësim më të mirë dhe aktive të organizatave të Rrjetit, në drejtim të forcimit dhe aktivizimit të tyre në këto problematika, duke filluar me një rishikim strukturor të tyre, rritjen e numrit të pjesëmarrësve dhe të vullnetarëve që i bashkëlidhen organizatave, duke shmangur mangësitë e vërejtura të mungesës së mjetueshme të stafit, të infrastrukturës, përfshirjes së një financieri si dhe të rritjes së aftësive të tyre për të komunikuar dhe reaguar. Po kështu ka patur rezultate është rritur aftësia e tyre për të aplikuar dhe hartuar projekte të ndryshme. Tashmë është bërë detyrim që të gjitha organizatat çdo muaj informojnë për arktivitetet e realizuar në kuadër të projektit, por edhe për

Vijon në faqe 12



Vijon nga faqe 11 pjesëmarrje apo aktivitete të tjera jashtë këtij projekti.

Por, duhet të pranojmë se ende nuk jemi në lartësinë e duhur, ende ka punë për tu bërë për të arritur standarte e një shoqërie evropiane, ende nuk jemi një zë i fuqishëm, duhet të punojmë dhe të bashkëveprojmë më mirë me organizatat e tjera, duke rritur e fuqizuar aftësitë dhe rolin tonë aktiv në zbatueshmërinë e legjislacionit, në luftën kundër korrupsionit dhe minimizimin e ndikimeve negative në menaxhimin e burimeve natyrore dhe zonave të mbrojtura, por edhe për të gjitha shqetësimet e tjera të shoqërisë shqiptare.



Në zbatimin e Programit SENiOR-II është bërë e mundur që çdo organizatë e RrMN të krijojë edhe një Rrjetëzim lokal me pjesëmarrjen e disa OJF-ve lokale, për të cilat kërkohet shumë punë që të konsolidohen dhe të kenë vijshmëri në funksionimin e këtyre rrjetëzimeve lokale në të ardhmen. Tashmë organizatat e RrMN janë pjesëmarrës dhe në grupime të ndryshme të shoqërisë civile në Shqipëri.

Gjatë zbatimit të Programit SENiOR-II është rritur komunikimi, informimi, advokimi, por edhe reagimi së bashku me komunitetet lokale, administrata përkatëse dhe grupet e interesit për evidentimin, hartëzimin dhe rrugëzgjdhjet për impaktet negative që ndikojnë mirëqeverisjen e ZMM dhe përdorimin jo të qëndrueshëm të burimeve dhe peizazhit natyror. Nëpërmjet aktiviteteve të planifikuara u mundësua një

përqasje strategjike e angazhimit të organizatave të RrMN, por dhe të OJF-ve lokale në adresimin afatgjatë të problematikës dhe promovimit të vlerave kryesore në Zonat e Mbrojtura Mjedisore.

Kemi bindjen se tashmë organizatat e RrMN janë të afta të nxitin një bashkëpunim sa më efektiv me strukturat administruese, menaxhuese, monitoruese dhe ligj zbatuese të fushës së natyrës në nivel qendror dhe pushtetin vendor, nëpërmjet partneritetit në iniciativa dhe aktivitete të përbashkëta që kanë për qëllim promovimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore.

Bashkëpunimi me të gjitha OJF lokale, stafet e bashkive, të arsimit, nxënësit e studentët, fermerët, komunitetin e grave dhe të biznesit, dhe kontributin e dhënë për realizimin e aktiviteteve të këtij projekti, ka qënë në një nivel të dëshiruar. Po kështu, bashkëpunimi i ndërsjellët, veçanërisht me Administratat e ZMM, ka qënë shumë rezultativ në mjaft probleme që shqetësojnë ZMM për një menaxhim dhe përqasje bashkëkohore, sipas standarteve ndërkombëtare, por edhe ndaj dukurive negative, duke qënë së bashku në luftën kundër tyre, thuajse në të gjitha ZMM të marra në studim.

Është vënë re se ka një rritje të bashkëpunimit dhe të prezencës së mediave lokale dhe kombëtare në aktivitetet tona, ndoshta kjo për faktin se disa nga aktivitetet tona kanë përbërë edhe lajm për mediat.

Vijon në faqe 13

Vijon nga faqe 12 Bazuar në platformën e hartuar nga REC u mundësua dhe u realizua organizimi i një aktiviteti masiv në Ditën Ndërkombëtare të Tokës (22 Prill), në PK "Divjakë-Karavasta", me mbi 300 pjesëmarrës nga të gjitha organizatat e RrMN, duke i paraprirë me disa aktivitete të promovimit të vlerave dhe adresimit të problematikave të ZMM me nënxësit e shkollave. Duke integruar aktivitetet e projektit, me iniciativën e qeverisë për një Shqipëri të pastër, krahas pastrimit, kemi kryer mbjelljen e 8000 fidanëve pyjor, nga të cilët 4500 copë u mbollën në PK "Divjakë-Karavasta". Të tilla aktivitete nga viti në vit kanë ardhur në rritje nga të gjitha organizatat.

Një aktivitet të dedikuar kemi realizuar me komunitetin e grave të parkut kombëtar "Divjakë-Karavasta" - në kuadër të barazisë gjinore, të cilat e kanë mirëpritur dhe dhanë një kontribut të jashtëzakonshëm, duke përcjellë edhe një mesazh të qartë dhe domethënës "Së bashku të kontribuojmë për ruajtjen, promovimin e vlerave dhe të mbajmë pastër territorin e parkut kombëtar "Divjakë-Karavasta", si një nga asetet

më të rëndësishëm të trashëgimisë natyrore të Shqipërisë", apo dhe mesazhi i përcjellë nga RrMN "NATURE COMES FIRST".

Sipas Strategjisë së RrMN, në fazën e II të projektit, puna e RrMN do të përqendrohet kryesisht në "Forcimin e rolit pjesëmarrës dhe advokues të organizatave, por edhe të OJF të identifikuar për promovimin dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në ZMM dhe për një vendimmarrje në interes të përbashkët".

Për këtë synojmë:

1. Vijimin e punës për ngritjen e kapaciteteve të organizatave të rrjetit mbi modelet e advokimit për një vendimmarrje dhe menaxhim sa më të qëndrueshëm të zonave të mbrojtura dhe burimeve natyrore;

- Hartimi i një metodologjie për mënyrat dhe modelet më të mira të advokimit dhe pjesëmarrjes publike me fokus problematikën në përdorimin e burimeve natyrore;

- Nxitjen e ngritjes së forumeve lokale mjedisore. INCA po udhëheq procesin e ngritjes së Forumeve Lokale, të cilët do të kenë në fokus synimin për nxitjen e

Vijon në faqe 14



Vijon nga faqe 13 pjesëmarrjes së publikut dhe OJF -ve në aspekte të rëndësishme të advokimit dhe vendimmarrjes në fushën e mbrojtjes së natyrës, të ZMM dhe përdorimit të burimeve natyrore, duke u përbërë një faktor mjaft të rëndësishëm në arritjen e synimeve të shprehura qartë në strategjinë e RrMN, sipas programit SENiOR-II, të programeve kombëtare, të konventave ndërkombetare dhe të Objektivave të Zhvillimit të Qendrueshëm.

Kësisoj është bërë e mundur krijimi dhe funksionimi i këtyre forumeve në ZMM "Llogara-Karaburun", "Shebenik-Jabllanicë", "Qafë Shtamë", "Ulëz", Liqeni i Shkodrës", "Mali i Dajtit", etj.

2. Angazhimi dhe evidentimi i përfshirjes së komunitetit dhe shoqërisë civile në proceset reaguese për të përmirësuar dhe ndikuar procesin e vendimmarrjes për menaxhimi e zonave të mbrojtura dhe burimeve natyrore;

- Aplikimi i disa takimeve konsultuese/informuese

dhe advokuese me aktorët e interesuar dhe strukturat lokale vendimmarrëse dhe kryerjen e sondazheve për vlerësimin e nivelit të pjesëmarrjes publike në takimet lokale vendimmarrëse. Monitorimi i pjesëmarrjes publike dhe përfshirjes së OJF-ve në mbledhjet e këshillave bashkiak.

3. Krijimi i modeleve të reja për zhvillimin e aktiviteteve me bazë natyrën në bashkëpunim me administratat lokale, nëpërmjet vitalizimit të Qendrës së Vizitorëve në PK.

4. Nxitja e angazhimit qytetar në mbrojtjen dhe promovimin e vlerave natyrore të ZMM;

- Nxitja e pjesëmarrjes së shoqërisë civile dhe komunitetit lokal drejt një procesi bashkëpunimi për promovimin e përbashkët të ZMM;

-Ndërmarrja e disa iniciativave për prononcime në median e shkruar dhe atë vizive, e cila është një tjetër palë e rëndësishme e një shoqërie demokratike.

Takim konsultues dhe ndërgjegjësues/informues në PK Qafë Shtamë / Miqësia Ulëz

PK Qafë Shtamë - 08/06/2018 - Organizata "Miqësia Ulëz" pjesë e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës në Shqipëri, në bashkëpunim me OJF-të lokale, përfaqësues të AKZM, AdZM Durrës, Inspektorjatit Mjedisor në Bashki dhe Njësinë Administrative si dhe grupe interesi të komunitetit lokal, përdorues të burimeve natyrore, biznese private dhe autoritete vendore, organizoi takimin e r a d h ë s m e t e m ë : "Takim konsultues dhe ndërgjegjësues/informues për vlerat e natyrës dhe ndarjen e barabartë të përfitimeve nga shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, informimi i tyre mbi gjetjet vlerësimet dhe advokimi mbi rekomandimet për minimizimin e impakteve negative në PK

Qafë Shtamë".


Në takim ishin të pranishëm përfaqësues nga REC Shqipëria dhe përfaqësues nga INCA.

Ky aktivitet realizohet në kuadër të Programit SENiOR-II, i zbatuar nga REC-Albania, me financim nga Qeveria Suedeze (Embassy of Sweden in Tirana).



Promovohet libri "Biologjia dhe mbarështrimi i faunës së gjetisë"

Tiranë - 08/06/2018 - Në ambientet e Fakultetit të Shkencave Pyjore në UBT, u promovua botimi i Prof.Dr. Anesti Postoli i financuar nga Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri - INCA "Biologjia dhe Mbarështrimi i Faunës së Gjetisë".



Qëllimi i hartimit të këtij libri është tu përgjigjet jo vetëm nevojave për formimin e studentëve dhe kualifikimin e të diplomuarve të

specialiteteve që lidhen me këtë fushë, por edhe kërkesave që kanë studjuesit e kësaj fushe, specialistët e terrenit, publiku i gjërë etj, për njohuri të cilat duhet jo vetëm të japin mundësi për një formim sa më të bazuar dhe shkencor, por të kenë gjithashtu një karakter sa më konkret e aplikativ për ti bërë njohuritë sa më të zbatueshme në kushtet e vendit tonë.

Në ceremoni morën pjesë përfaqësues të AKZM, INCA, akademike dhe studente të shkencave pyjore.



Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore në ZM në Gjirin e Vlorës / Shoqata Flag Pine

PK Llogara 09/06/2018 - Organizata Flag Pine pjesë e Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës i cili drejtohet nga INCA, organizoi takimin informues mbi aplikimin e praktikave ekoturistike në zonat e mbrojtura si dhe trajnimin e guidave turistike lokale mbi zbatimin e rregulloreve në shtigjet mjedisore.

Të pranishëm në takim ishin përfaqësues të pushtetit vendor, AdZM Vlorë, REC Shqipëri, INCA, operatorë turistik dhe OJF-ve të zonës, guida lokale, përfaqësues të medias etj.

Ky aktivitet u zhvillua në kuadër të programit SENiOR-

II zbatuar nga REC Shqipëri dhe financuar nga Ambasada Suedeze.



Nxitja e krijimit dhe funksionimit të forumeve lokale mjedisore në PK Mali i Dajtit /Pседа Iliria

PK Mali i Dajtit - 28/06/2018 - Në kuadër të zbatimit të projektit "Promovimi dhe advokimi për një menaxhim të qëndrueshëm të burimeve dhe vlerave natyrore në zonat e mbrojtura" (Faza II), organizata ILIRIA, organizoi bashkëbisedimin me grupet e interesit për "Nxitja e krijimit dhe të funksionimit të forumeve lokale mjedisore". Qëllimi i takimit ishte të konsultojë dhe identifikojë, në bashkëpunim me grupet e interesit në nivel lokal, përfaqesjen më të mirë të përfshirjes së tyre në proceset e advokimit dhe mirëmenaxhimit të Parkut Kombëtar Mali i Dajtit, nëpërmjet përfaqësimit të aktorëve kryesorë lokal në një strukturë të përbashkët - Forumi Lokal, pranë strukturave vendore përgjegjëse në Parkun Kombëtar "Mali i Dajtit".

ILIRIA do të propozojë modelin e strukturës dhe mënyrën e funksionimit të këtij forumi bashkë me stafin e Bashkisë dhe Administratën e Parkut Kombëtar. Gjithashtu, ILIRIA do të synojë informimin dhe ndërgjegjësimin e anëtarëve të



forumit mbi problematikat e vrejtura (gjatë fazës së I-rë të projektit) dhe rekomandimet për zgjidhjen e tyre, bazuar në legjislacionin e fuqi. Ky aktivitet u realizua në kuadër të Programit SENIOR-II, i zbatuar nga REC-Albania, me financim nga Qeveria Suedeze (Embassy of Sweden in Tirana).

Në takim morrën pjesë përfaqësues të AdZM Tiranë, përfaqësues të organizatave të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës, të INCA, të shoqërisë civile të zonës etj.

Konferencë Rajonale mbi pjesëmarrjen e publikut

Stamboll - 28/06/2018 - Zhvilloi punimet në Stamboll Konferenca Rajonale mbi pjesëmarrjen e publikut. Konferenca u zhvillua në kuadër të projektit CO-SEED "Shoqëria Civile Vepron për Zhvillimin Social-Ekonomik mbi Bazat e një Mjedisit të Shëndetshëm" me pjesëmarrjen e organizatave partnere nga Shqipëria, Bosnja-Heregovina, Mal i Zi, Serbi, Turqi dhe organizatat fituese të granteve në kuadër të këtij projekti.

Konferenca kishte në fokus synimin për nxitjen e pjesëmarrjes së publikut dhe shoqërisë civile në aspekte të rëndësishme të politikbërjes dhe vendim-marrjes në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke përbërë një

faktor mjaft të rëndësishëm në arritjen e synimeve të mbrojtjes së mjedisit të shprehura qartë në konventat ndërkombetare dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni www.co-seed.eu



Si e përmirëson pjesëmarrja publike vendimmarrjen për çështjet mjedisore?



Fragmente nga manuali i praktikave më të mira botërore

Shteti: **Sloveni**

Rasti: Programi i zhvillimit rural

Theksi: Shkëmbimi i dyanshëm i informacionit sjell si rrjedhojë një zhvillim më të përhapur.

Kur Sllovenia po hartonte Programin e Zhvillimit Rural, u krye një VSM për të analizuar përputhshmërinë me objektivat mjedisore të vendit. Ministria përgjegjëse ftoi publikun të merrte pjesë gjatë të gjithë procesit, si dhe u zhvillua një model i veçantë për ndarjen e informacionit dhe bashkëpunim. Sigurimi i pjesëmarrjes së organizatave të ndryshme në nivel vendor dhe rajonal, partnerëve socialë, OJQ-ve, dhe profesionistëve, ishte thelbësor.

Ministria përgjegjëse publikoi në faqen e saj propozimin për Programin e Zhvillimit Rural dhe mori 50 vërejtje nga individë dhe organizata.

Komunikimi ndërmjet publikut dhe Ministrisë ishte proces i dyanshëm. Ministria dha përgjigje dhe mendime me shkrim lidhur me çdo sugjerim, propozim dhe pyetje. Për publikun e interesuar Programi ishte i disponueshëm në CD, në formë të shkruar, si dhe nëpërmjet emailit. Krahas kësaj, Ministria ngriti një forum në një faqe interneti ku zyrtarët publikë mund t'iu përgjigjeshin pyetjeve të ndryshme. Gjithashtu u zhvilluan disa takime bashkërenduese, workshop-e, dhe botime lidhur me propozimin për Programin.

Në media u publikuan hollësitë rreth dëgjësës publike. Pas kësaj dëgjese, Ministria nxori një propozim të ri për një Program të përditësuar në bazë të vërejtjeve të bëra gjatë dëgjësës publike. Para nxjerrjes së propozimit të ri, u shpjeguan arsyet pse vërejtjet dhe sugjerimet ishin apo nuk ishin pasqyruar në Programin e përditësuar.

#IAmOnEnergySavingMode / Qendra EDEN

Shkodër, Elbasan, Tiranë, Berat, Vlorë 4-8/06/2018 - Rrjeti i vigjilencës mjedisore, "Një sy për mjedisin" në kuadër të Javës Evropiane të Qëndrueshmërisë Energjetike 4-8 Qershor 2018, zhvilloi një fushatë informuese dhe ndërgjegjëse nën moton #IAmOnEnergySavingMode. Fushata u zhvillua me një larmi oranzimesh: me takime, me diksutime në grup, me vizita studimore dhe me ndërtimin e maketeve të qytetit dhe shtëpisë së dëshiruar eficiente për energjinë. Për të sjellë më afër rolin e rëndësishëm që ka secili prej nesh, nxënësit e vendosën veten e tyre në rolin e një kryetari bashkie, e një ministri, në vendin e kryefamiljarit etj. Të rinjtë pasi prezantoheshin me raportin "Vlerësimi i performancës së energjisë në ndërtesa përmes konceptit të varfërisë energjetike" <http://www.eden-al.org/>

[images / Publikime / W Raport Vlersimi i performancs s energjis n ndrtesa prmes konceptit t varfris energjeti ke.pdf](#) zhvillonin mesazhet nën moton e fushtatës. Mesazhet në formë të shkruar, apo me video u paraqitën nga nxënësit e 13 shkollave të mesme, 2 shkolla 9 vjeçare, 1 universitet, nga 2 forume rinore të partive politike; duke bashkuar bashkë më shumë se 500 persona. Të rinjtë ishin të njohur me terma si efienca e energjisë, zhvillim i qëndrueshëm, burime alternative, mbrojtjen e mjedisit etj. Megjithatë nevojiten më shumë nisma të këtij niveli që i drejtohen qytetarëve për të rritur dhe më tej rëndësinë e kësaj teme si dhe për të ndikuar në ndryshimin e sjelljeve të banorëve në përdorim më eficient të energjisë. Disa nga mesazhet e përcjella gjatë javës:

- Përdorni panele fotovoltaike për

Vijon në faqe 18

Vijon nga faqe 17



tu ngrohur në vend të rezistencës elektrike - Kush nuk kursen energji duhet të gjobitet (Si Ministër i Energjisë)

- Kush kursen energji duhet të shpërblehet (Si Ministër i Energjisë)

- Duhet të investohet në fasadën e ndërtesës për të rritur izolimin

- Një mënyrë alternative për ngrohjen e mjediseve të shkollës është nga biomasa

- Donacion për panelet fotovoltaike për familjet vulnerabël (Roli i kryetarit të B a s h k i s ë)

- Mendoni për një zhvillim të qëndrueshëm në në ambientet ku jetoni dhe punoni e studioni

- Jini aktiv në proceset vendimmarrëse që përmirësojnë eficienten e energjisë të ndërtesave

- Mbroje ambjentin duke kursyer

- Duhet fushat ndërgjegjësuese për banorët në lidhje me eficienten e energjisë

- Reduktim prej 20% i çmimit të energjisë për familjet e pambrojtura

- Investimi në energji të pastër, është një investim për të ardhmen

Rrjeti i Vigjilencës mjedisore falenderon shkollat të cilat ishin të gatshme të bashkëpunonin dhe në veçanti falenderon nxënësit dhe të rinjtë të cilët pasuruan me ide eficiente çdo aktivitet.

Fotot dhe videot e kësaj fushate mund të shihen përmes faqes facebook të rrjetit:

Fotografite: [#IAMOnEnergySavingMode](https://www.facebook.com/pg/Nje-sy-per-mjedisin-653239758088964/photos/?tab=album&album_id=1903787333034194)
https://www.facebook.com/pg/Nje-sy-per-mjedisin-653239758088964/photos/?tab=album&album_id=1903787333034194

Videot: [#IAMOnEnergySavingMode](https://www.facebook.com/pg/Nje-sy-per-mjedisin-653239758088964/videos/?ref=page_internal)
https://www.facebook.com/pg/Nje-sy-per-mjedisin-653239758088964/videos/?ref=page_internal

Rrjeti i vigjilencës mjedisore: Qendra Mjedisore për Zhvillim, Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)- Organizata drejtuese; Klubi Ekologjik Elbasan (KEE); Për Mirëqenie Sociale dhe Mjedisore (PMSM); Qendra e Informacionit Aarhus Shkodër (AIC); Qendra për Kërkim, Bashkëpunim dhe Zhvillim (CRCD); Qendra për Mbrojtjen e Ekosistemeve Natyrore në Shqipëri (EcoAlbania). Fushata informuese ndërgjegjësuese është zhvilluar në kuadër të projektit "Së bashku një sy për mjedisin", financuar nga Ambasada Suedeze në Shqipëri, në kuadër të Programit për Mbështetje të Organizatave të Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENIOR II) zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisir (REC) në Shqipëri.

5 Qershori - Dita Botërore e Mjedisit

Më 5 qershor të vitit 1972, OKB-ja zhvilloi në Stokholm të Suedisë konferencën e parë të mjedisit ku u miratuan "Manifesti i Mjedisit të Njerëzimit" dhe "Plani i Veprimeve". Sipas propozimeve të konferencës së Stokholmit, në tetor të vitit 1972, Asambleja e 27-të e Përgjithshme e OKB-së vendosi të krijojë "Programin e Mjedisit të OKB-së" dhe e caktoi zyrtarisht 5 qershorin si "Ditën Botërore të

Mjedisit". Qysh nga viti 1974, Programi i Mjedisit i OKB-së cakton çdo vit një temë për Ditën Botërore të Mjedisit duke zhvilluar aktivitete përkatëse propaganduese për të forcuar ndërgjegjen e njerëzve për mbrojtjen e mjedisit dhe të ambjenteve ku jetojnë. Dita Botërore e Mjedisit, që përkujtohet më datën 5 Qershor të çdo viti, është një mundësi që njerëzit në të gjithë botën të

Vijon në faqe 19

Vijon nga faqe 18 mendojnë rreth efekteve negative të shkatërrimit të mjedisit, si në nivel lokal ashtu dhe global. Ka shumë çështje ndërkombëtare të mjedisit që kanë nevojë për vëmendje urgjente, të tilla si Ndryshimi Klimatik, Biodiversiteti, Siguria Mjedisore, të cilat ndikojnë në shëndetin e planetit tonë, banorëve, florës dhe faunës së tij.

Me "Goditjen ndaj Ndotjes Plastike", e përzgjedhur si tematika e vitit 2018, e tërë Bota është bashkuar për të luftuar ndotjen plastike një-përdorimshe.

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara,

në mesazhin e tij kushtuar kësaj dite u bën thirrje të gjithëve të ndërmarrin masa konkrete kundër ndotjes plastike. "Goditja ndaj Ndotjes Plastike", si tematika e përzgjedhur për vitin 2018, nxit qeveritë, industrinë, komunitetet dhe individët që të bashkohen dhe të zbulojnë alternativa të qendrueshme dhe të ulin në mënyrë urgjente prodhimin dhe ndotjen e jashtëzakonshme të oqeanëve tona nga plastikat një-përdorimshe duke dëmtuar jetën detare dhe kërcënuar shëndetin e njerëzve.

**BEAT
PLASTIC
POLLUTION**



**WORLD
ENVIRONMENT
DAY**



**INDIA
2018**

UN
environment

NJOFTIME

- 7 Korrik - Dita e pranimit në UNESCO e pyjeve të vjetër të ahut të zonës së Lumit të Gashit dhe Rrajcës
- 11 Korrik - Dita Botërore e Popullsisë
- 16 Korrik - Dita e krijimit të Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA
- 28 Korrik - Dita Botërore e Rruajtjes së Natyrës
- 31 Korrik - Dita Ndërkombëtare e Rangers-ave
- 1 - Për të lexuar "Ditari i Natyrës" në vite...

<http://www.inca-al.org/index.php/sq/publikimet/ditari-i-natyres>

Udhëzime për të kontribuar në Ditarin e Natyrës

Instituti për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri mirëpret artikuj të ndryshëm të cilët ju dëshironi t'i publikoni në Ditarin e tij elektronik. Artikujt duhet të jenë jo më shumë se 200 - 250 fjalë. Ju lutemi të merrni në konsideratë këtë kërkesë, pasi interesi për të shpërndarë artikuj, lajme apo njoftime të ndryshme përmes Ditarit, mund të jetë i konsiderueshëm dhe ne do të përpiqemi për të siguruar hapësirë për të gjithë ju që dëshironi të kontribuoni. Redaksia ruan të drejtën për të shkurtuar apo modifikuar (jo tjetërsuar) tekstin nëse do të jetë e nevojshme.


Ju lutemi dërgoni një foto shoqëruese për artikullin tuaj dhe / ose web - link për referencë të mëtejshme.

Faleminderit për marrjen në konsideratë të këtyre udhëzimeve!

Grupimi "Të Shpëtojme Arinjtë Shqiptarë"



Organizatat Partnerë të Rrjetit për Mbrojtjen e Natyrës



Botim i Institutit për Ruajtjen e Natyrës në Shqipëri / INCA